



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.59, datë 31.03.2022

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN
DURIM BEDINI, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KAVAJË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a" dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 32 dhe nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Durim Bedini, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Durim Bedini, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Durim Bedini të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Durim Bedini.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
5. U shpall sot më datë 31.03.2022

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
ALFRED BALLA**





ANËTAR
SOKOL STOJANI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR
ESMERALDA KESHI


ANËTAR
ZEQIR HODA



ANËTAR
LUDOVIK DODAJ



ANËTAR
MIRELA BOGDANI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ

